

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL

KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së

ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-188/15

Prishtinë

17 Janar 2018

Në çështjen juridike të:

D. Š.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/236/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA34324), të datës 30 prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 Janar 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet si e papranueshme ankesa e D. Š. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014 e datës 30 prill 2014 sa i përket Kërkesës së regjistruar me numrin KPA34324.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 3 Maj 2007 N.S. Š. (më tutje “paraqitësi i kërkesës”), ka paraqitur një Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje “AKP”) duke kërkuar kthimin e posedimit të pronës që ndodhet në fshatin Gërlicë të Ferizajt, në ngastrën kadastrale nr.376 Komuna Kadastrale Gërlicë/Grlica, me kulturë pemishte, me sipërfaqe prej 0.16.38 h (më tutje “prona e kërkuar”). Ai pretendon se vjehëri i tij N. N. K. ishte pronar i ngastrës dhe se e njëjta ishte humbur si pasojë e konfliktit të armatosur duke përmendur datën 11 Qershor 1999. Më tej ai pretendon se prona ishte e uzurpuar dhe kërkon kthimin e posedimit.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai i dorëzoi këto dokumente në AKP:
 - Një kopje të fletës poseduese nr.2 lëshuar me 6 dhjetor 1999 nga shërbimi kadastral i Ferizajt i dislokuar në Serbi me të cilin dëshmohej se prona e kërkuar evidentohej në emër të vjehërit të tij N. K.
 - Kopje e letërnjoftimit e lëshuar nga Komuna e Gjilanit me 16 Maj 1997.
 - Certifikatë e vdekjes e N. K., e lëshuar me 11 Shkurt 1967 me të cilën dëshmohej se N. K. kishte vdekur me 8 Shkurt 1967.
3. Identifikimi i kërkesës është kryer me 9 dhjetor 2009 dhe prona ishte gjetur tokë e kultivuar dhe nuk ishte paraqitur askush në momentin e vizitës.
4. Pasi që asnjë palë nuk paraqiti Përgjigje ndaj kërkesës brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr.03/L-079, kërkesa u konsiderua si e pa kontestuar.
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e informoi paraqitësin e ankesës se do të duhej të sillte autorizim valid nga trashëgimtaret e mundshëm e të ndjerit N. por ai kishte dështuar të sjell atë në kohën e kërkuar.
6. Pasi që paraqitësi i kërkesës dështoi të sjellë autorizim ose aktvendim trashëgimie, Sekretaria ekzekutive përmes Urdhër Vendimit Nr ES/46/2010 kishte vendosur ta hedhë kërkesën në kuptim të nenit 4.3 të Urdhëresës Administrative 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Paraqitësi I kërkesës e kishte pranuar vendimin me 26 Prill 2010 dhe të njëjtën ditë ka paraqitur ankesë në këtë vendim. Sekretari Ekzekutive i ka referuar kërkesën Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës.

7. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës, përmes Vendimit KPCC/D/C/236/2014 të datës 30 prill 2014, vendosi që ta hedh poshtë kërkesën duke sqaruar se pala ankuese nuk është anëtar i familjes (siç përkufizohet në nenet 1 dhe 5 të Urdhërësës Administrative 2007/5, të miratuar me Ligjin Nr.03/L-079), në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Gjithashtu, pala ankuese nuk mban një autorizim të vlefshëm dhe të ekzekutuar në mënyrë të rregullt që e autorizon atë të veprojë në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Për më tepër, sipas KKPK-së, pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi se ai vetë gëzon ndonjë të drejtë të pronësisë mbi pronën e kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar *ex officio* ndonjë dëshmi të tillë. Vendimi i KKPK-së në arsyetimin e dhënë në paragrafin 36 sqaron se për arsye e njëjta Sekretaria e kishte hedh kërkesën.
8. Vendimi iu dorëzua palës më 17 Tetor 2014. Me 14 Nëntor 2014 D. Š. e vajzërisë K. (tani e tutje “pala ankuese” paraqiti ankesë

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendoi askush nga Agjencia nuk i ka kërkuar të dëshmoi lidhjen familjare me paraqitësin e kërkesë. Ajo pohon se i shoqi ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bashkëshortit për pronën e kërkuar të të ndjerit babait të saj.
10. Pala ankuese sqaroi se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk i kishte kërkuar asaj dokumente dhe se për Vendimin e KPKK-së ishte njoftuar vetëm në ditën e pranimit.

Arsyetimi ligjor

11. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të pretendimeve të ankesës dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, konkludon se vendimi i KKPK-së nuk përfshin ndonjë gabim thelbësor ose zbatim të gabuar të rëndë të së drejtës materiale në fuqi, e as nuk mbështetet në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Ankesa ishte paraqitur nga personi fizik që nuk ka marr pjesë në procedure në shkallën e parë. Për arsyet e poshtëcekura ankesa është e pa pranueahme.
12. Ankesa është e papranueshme në baza procedurale (Neni 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079) sepse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurë në shkallë të parë.
13. Neni 10.2 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh se çdo person tjetër pos paraqitësit të ankesës i cili aktualisht ka për qëllim të ketë të drejta mbi pronën e cila është objekt i kësaj kërkesë dhe/ose çdo person i cili mund të ketë interes ligjor në pronën e pretenduar do të jetë palë e kërkesës dhe e procedurës lidhur me atë me kusht që personi i atillë ta informojë AKP-në për synimin e tij ose të saj që të merr pjesë në procedurë.

14. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 përcakton se: “brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga AKP-ja për vendimin e KKPK-së për kërkesa, pala mund të paraqesë [...] ankesë ndaj vendimit të tillë.”
15. Pala ankuese nuk kanë qenë palë në procedurë në shkallë të parë para KKPK-së. Pala ankuese nuk e arsyetojnë se pse nuk kanë marrë pjesën në shkallë të parë në mënyrë që të mund të pranohen si palë në procedurë tani.
16. Gjykata vëren se njoftimi i kërkesës në shkallë të parë është bërë siç duhet. Ekipi i AKP-së ka vendosur një shenjë njoftuese në tri gjuhë – shqip, serbisht dhe anglisht – në vendin ku ka qenë prona e kërkuar (shih shkresat e lëndës faqe 27).
17. Nuk ekziston asnjë arsytim se pse pala ankuese nuk e ka informuar AKP-në për qëllimin e saj për të marrë pjesë në procedurë edhe përkundër faktit se AKP-ja e ka kontaktuar disa herë bashkëshortin e palës ankuese në cilësinë e paraqitësit të kërkesës. Gjykata nuk mund ta merë si të besueshëm deklarin e palës ankuese se në kohën kur bashkëshorti i saj ka komunikuar me AKP-në ajo të mos ketë ditur për kërkesën apo të mos e autorizonte bashkëshortin e saj.
18. Prandaj ankesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme (neni 13.3 (b) i Ligjit nr. 03/L-079; shih gjithashtu nenin 176.1 dhe 195.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore).
19. Pasi që ankesa është e papranueshme, Gjykata Supreme nuk mund të shqyrtoj meritat e ankesës si dhe nuk mund të vendos as edhe për çështjen e juridiksionit të KKPK-së/AKP-së, apo edhe për çështjet ligjore lidhur me të drejtat pronësore për pronën e kërkuar.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it